



## Periodiku AMF

**Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, midis AMF-së, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit**

Më datë 31 mars 2011, në ambientet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjatë ceremonisë së inaugurimit të godinës së re, u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Shkëmbimit të Informacionit, për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit, midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

*Vijon në faqen 2*

### AMF inauguron ndërtesën e re

Më datë 31 mars 2011, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi ceremoninë e inaugurimit të godinës së re të institucionit, pas një sërë zhvillimesh pozitive dhe një pune të suksesshme që nga krijimi i tij në tetor të vitit 2006.

*Vijon në faqen 3*

### Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

#### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-shkurt 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janar-shkurt 2011 arritën shifrën 1,471,420 mijë lekë, përkundrejt 1,380,294 mijë lekë të realizuara në janar-shkurt 2010 ose 6.60 % më shumë.

*Vijon në faqen 4*

### Ngjarje dhe zhvillime të tjera

**Mbi raportimin në Komisionin e Ekonomisë së Kuvendit të Shqipërisë, të Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2010**

Më datë 11 mars 2011, Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, raportoi pranë Komisionit të Ekonomisë, në Kuvendin e Shqipërisë, mbi aktivitetin e institucionit dhe zhvillimet e tregjeve financiare jo-bankare, gjatë vitit 2010.

*Vijon në faqen 6*

### Mbi licencimin e “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Sigal-Life UNIQA Group AUSTRIA” sh.a.

Në mbledhjen e datës 30 mars 2011, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, miratoi dhënien e licencës “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Sigal-Life UNIQA Group AUSTRIA” sh.a. për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, në përputhje me Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

*Vijon në faqen 7*

### Edukimi i konsumatorit

#### Bazat e Risigurimit

*(Material i përpunuar, i autorit Rodolfo Wehrhahn, nxjerrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore, prill 2010)*

*Vijon nga numri i kaluar...*

#### Aneksi III

#### Deklarata Publikuese e Ndërmjetësit të Risigurimit

#### Guy Carpenter Afirmon Angazhimin për Publikim të Plotë

*(New York, 16 dhjetor 2004)*

Në një letër për klientët, të datës 1 dhjetor 2004, duke njoftuar politikën e re, Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv i Guy Carpenter, Salvatore D. Zaffino, vuri në dukje se “brenda tregut të risigurimeve duhen trajtuar çështjet e publikimit të plotë tek klientët.”

*Vijon në faqen 7*

## Në këtë numër:

Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, midis AMF-së, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **4**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **6**

Edukimi i konsumatorit **7**

## Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, midis AMF-së, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit



Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Më datë 31 mars 2011, në ambientet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjatë ceremonisë së inaugurimit të godinës së re, u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Shkëmbimit të Informacionit, për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit, midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

Nënshkrimi i marrëveshjes, firmosur nga Zj. Elisabeta Gjoni Kryetare e AMF-së, Z. Sokol Olldashi Ministër i Punëve Publike dhe Transportit dhe Z. Avenir Peka, Zv/Ministër i Brendshëm, synon sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe autoriteteve përgjegjëse për monitorimin e trafikut rrugor e kalimit kufitar, si dhe administrimin e shërbimeve të transportit rrugor.

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve zbatuese.

Në fjalën e saj, Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së, vlerësoi rëndësinë e nënshkrimit të kësaj

marrëveshje për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit. Kryeministri i vendit Prof. Dr. Sali Berisha, i pranishëm në këtë ceremoni, vlerësoi punën e vazhdueshme të tre institucioneve në arritjen e kësaj marrëveshje.



Marrëveshja do të mundësojë kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme, zvogëlimin e numrit të mjeteve të transportit të pasiguruara, kontrollet e përbashkëta dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të qarkullimit të mjeteve motorike.

### AMF inauguron ndërtesën e re

Më datë 31 mars 2011, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi ceremoninë e inaugurimit të godinës së re të institucionit, pas një sërë zhvillimesh pozitive dhe një pune të suksesshme që nga krijimi i tij në tetor të vitit 2006.

Në takimin e ndjekur nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, mori pjesë Kryeministri i vendit, Prof. Dr. Sali Berisha, Ministri i Financave Z. Ridvan Bode, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Z. Sokol Olldashi dhe personalitete të tjera në vend.

Në fjalën e hapjes, Kryetarja e AMF-së, Zj.



Gjatë ceremonisë së inaugurimit të godinës së re të AMF-së



Elisabeta Gjoni, vlerësoi mbështetjen e Kryeministrit dhe rolin e Qeverisë në krijimin e AMF-së dhe theksoi se godina e re konturon ngritjen e një institucioni të ri, i cili në sajë të një axhende tepër të ngjeshur katër vjeçare, vjen pas rishikimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor që rregullon tregjet financiare jo-bankare, me miratimin e 6 (gjashtë) ligjeve të rëndësishme, me një treg sigurimesh që reflekton qëndrueshmëri me futjen e kapitalit të huaj, me një metodologji të mbikëqyrjes me fokus riskun dhe me licencimin e shoqërisë së dytë administruese të fondeve të pensionit vullnetar.

Në fjalën e tij Kryeministri i vendit, Prof. Dr. Sali Berisha vlerësoi punën e bërë nga AMF gjatë këtyre viteve dhe përgëzoi Kryetaren e AMF-së së bashku me stafin për përballimin me sukses të sfidave që karakterizojnë ngritjen e një institucioni të qëndrueshëm e të konsoliduar për të mbikëqyrur tregun financiar jo-bankar. Gjithashtu Kryeministri vlerësoi progresin dhe zhvillimet pozitive në këto tregje vitet e fundit në drejtim të lirisë dhe hapësirave që janë krijuar për investimet e huaja.

Vetë Kryeministri i Vendit, Prof. Dr. Sali Berisha preu shiritin e inaugurimit në shenjë simbolike të përkrahjes dhe mbështetjes së vazhdueshme që Qeveria i ka dhënë AMF-së në forcimin e rolit si rregullator i integruar i tregjeve financiare jo-bankare.

Godina e re, përmbush të gjitha kriteret për t'u cilësuar si një godinë me infrastrukturë moderne, e cila garanton vazhdimësi të axhendës ambicioze të institucionit. Godina përmban 3 kate, në të cilat janë pozicionuar 23 zyra ku punon një staf prej 48 punonjësish, një sistem modern Audio-Video Konferencë, nga një sallë takimesh në çdo kat, e dizenuar nga arkitektë të njohur dhe e pasuruar me vepra të artistëve si S. Spahija, P. Kolnikaj, R. Tasho, etj. Ajo që është më e rëndësishme, godina e re garanton instalimin e veprave ambicioze të institucionit në drejtim të Teknologjisë së Informacionit si Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik dhe Platforma elektronike e raportimit të subjekteve në AMF.


Dinamika dhe ritmi i lartë i punës së institucionit bëjnë që fotografimi i një panorame të përgjithshme të arritjeve është i pamundur. Në çdo ditë, javë, muaj, në mënyrë të vazhdueshme kësaj liste i shtohet një ngjarje e re. Vetëm sot, jepet lajmi i dhënies së licencës shoqërisë së dytë administruese të fondeve pensionit vullnetar, Sigal-Life Uniqa Group Austria, prezantohet publikimi më i ri i AMF “Sigurime – 10 vjet statistika” si dhe u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-shkurt 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janar-shkurt 2011 arritën shifrën 1,471,420 mijë lekë, përkundrejt 1,380,294 mijë lekë të realizuara në janar-shkurt 2010 ose 6.60 % më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 58.14% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 41.86% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 64.18% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje 0.96% të sigurimeve të Jo-Jetës. 86.26% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës dhe 13.74% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës. Në janar-shkurt 2011 u nënshkruan rreth

189,958 kontrata sigurimi, ose rreth 121.89% më shumë se në 2010.



### Volumi i primit të shkruar bruto, janar-shkurt (2010-2011)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2010	2011
<b>Janar - Shkurt</b>		
A) Sigurim i Jetës	123,123	202,140
B) Sigurim i Jo-Jetës	1,257,171	1,269,280
a) Sigurimi Detyrueshëm	568,785	616,004
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	688,386	653,277
c) Risigurimi	-	-
<b>TOTAL</b>	<b>1,380,294</b>	<b>1,471,420</b>

## Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-shkurt 2011, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 41.86 % të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-shkurt 2011, arritën 360,750 mijë lekë, ose 15.03% më pak se në janar-shkurt 2010.

Në janar-shkurt 2011, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 223,462 mijë lekë, ose rreth 105.54 % më shumë se në janar-shkurt 2010.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janarit-shkurt 2011 arritën në 31,797 mijë lekë, apo 10.45% më pak se në janar-shkurt të 2010.

## Sigurimet vullnetare

Në janar-shkurt 2011, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 855,416 mijë lekë, ose 5.41% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 653,277 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 31.03% të pasuara nga, sigurimi kasko me 14.29% dhe nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 14.01% peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-shkurt 2011, arritën në 167,936 mijë lekë, 202.13% më shumë se në janar-shkurt 2010. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 89.18% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar-shkurt 2011

arritën në 202,140 mijë lekë, ose rreth 64.18% më shumë se në janar-shkurt 2010. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie.

## Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbani, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 37.32 % të primeve.



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 42.25% të primeve.

## Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-shkurt 2011 kapi vlerën 336,805 mijë lekë, ose 7.21 % më shumë se në janar-shkurt 2010. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 221,243 mijë lekë, apo 65.69 % të totalit.

## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### **Mbi raportimin në Komisionin e Ekonomisë së Kuvendit të Shqipërisë, të Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2010**

Më datë 11 mars 2011, Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, raportoi pranë Komisionit të Ekonomisë, në Kuvendin e Shqipërisë, mbi aktivitetin e institucionit dhe zhvillimet e tregjeve financiare jo-bankare, gjatë vitit 2010.

Në fjalën e saj, Zj. Gjoni bëri një përmbledhje të veprimtarisë së institucionit, arritjeve dhe sfidave me të cilat AMF përballet në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri.

Midis të tjerave, Zj. Gjoni vuri theksin tek zhvillimet e rëndësishme në tregun e sigurimeve, si treg me peshën kryesore në tregun financiar jo-bankar në Shqipëri. Viti 2010 u fokusua në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, në vijim të një pune tre-vjeçare për një mbikëqyrje më efektive, ku konkretisht arritjet janë si më poshtë:

- Prezantimi i manualit të mbikëqyrjes me fokus-risikun;
- Hartimi i projektligjit të ri në fushën e sigurimeve, i cili do të mbështesë modelin e ri të

mbikëqyrjes me fokus risikun dhe do të bëjë të mundur harmonizimin e legjislacionit të fushës me direktivat e BE-së dhe praktikat më të mira në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve;

- Vënia në zbatim e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, i cili përbëhet nga një platformë raportimi web.

Më tej, Zj. Gjoni prezantoi zhvillimet e këtij tregu gjatë vitit 2010, ku midis të tjerave veçoi faktin që tregu i sigurimeve ka ruajtur rritje pozitive: 4% më shumë se në vitin 2009, ritëm ky më i lartë, krahasuar me atë botëror, evropian apo dhe me disa vende në rajon. Viti 2010 vazhdoi tendencën e përmirësimit të strukturës së tregut në favor të sigurimeve vullnetare, si dhe të një dinamike të lartë të tyre.

Gjithashtu, gjatë fjalës së saj, Zj. Gjoni përmendi që AMF i ka kushtuar vëmendje dhe energji të veçantë rritjes së kapaciteteve institucionale, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore, modernizimit të infrastrukturës teknike, kërkuese, etj.

Në raportim u paraqit edhe roli aktiv i AMF-së në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, si dhe masat e marra në kuadër të mbikëqyrjes së tregjeve nën juridiksionin e AMF-së.

Në përfundim, Zj. Gjoni bëri një paraqitje të objektivave afat-mesme të institucionit, sfidave me të cilat përballet institucioni në funksion të realizimit të këtyre objektivave dhe më pas iu përgjigj pyetjeve të anëtarëve të komisionit që kishin të bënin me forcimin e kuadrit ligjor në fushën e sigurimeve, politikave të investimit të fondeve të pensionit, instrumentat e disponueshëm nga AMF në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, etj.

Raporti i plotë i veprimtarisë, iu vu në dispozicion anëtarëve të Komisionit, të cilët vlerësuan pozitivisht punën e institucionit dhe arritjeve konkrete që nga krijimi i tij.



## **Mbi licencimin e “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Sigal-Life UNIQA Group AUSTRIA” sh.a.**

Në mbledhjen e datës 30 mars 2011, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, miratoi dhënien e licencës “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Sigal-Life UNIQA Group AUSTRIA” sh.a. për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, në përputhje me Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Shoqëria administruese e fondeve të pensionit “Sigal-Life UNIQA Group AUSTRIA” përfaqëson shoqërinë e dytë, të licencuar nga Bordi i AMF-së për administrim të fondeve të pensionit vullnetar. Gjykuar nga veçoritë që paraqet administrimi i fondeve të pensioneve vullnetare, Bordi i kushtoi një rëndësi të madhe profesionalizmit të stafit drejtues të shoqërisë administruese dhe veçanërisht kontributit që do japin në ecurinë e shoqërisë përfaqësuesit e UNIQA Group AUSTRIA.

Rritja e numrit të operatorëve në tregun e pensioneve vullnetare, do të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e këtij tregu dhe do të rrisin më tej besueshmërinë e publikut në investimin e fondeve në skemën e pensioneve vullnetare.

## **Edukimi i konsumatorit**

### **Bazat e Risigurimit**

*(Material i përpunuar, i autorit Rodolfo Wehrhahn, nxjerrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore, prill 2010)*

*Vijon nga numri i kaluar...*

### **Aneksi III**

### **Deklarata Publikuese e Ndërmjetësit të Risigurimit**

### **Guy Carpenter Afirmon Angazhimin për**

## **Publikim të Plotë**

(New York, 16 dhjetor 2004)

Në një letër për klientët, të datës 1 dhjetor 2004, duke njoftuar politikën e re, Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv i Guy Carpenter, Salvatore D. Zaffino, vuri në dukje se “brenda tregut të risigurimeve duhen trajtuar çështjet e publikimit të plotë tek klientët.”

“Marrëdhënia e Guy Carpenter me klientët e tij ndërtohet mbi besimin afatgjatë dhe aftësinë tonë për t'i ndihmuar klientët tanë që të marrin vendime të rëndësishme në një mjedis të vështirë. Transparenca dhe publikimi i plotë duhet të forcojnë besimin midis gjithë palëve për kontratën e risigurimit dhe duhet të inkurajojnë vendimmarrje më të mira. Meqenëse njoftuam angazhimin tonë për transparencë, reagimet nga klientët dhe tregjet e risigurimit në mbarë botën kanë qenë tej mase pozitive”, - tha Zaffino.

“Ky biznes përballet me shumë sfida për momentin, nga rënia e përqindjeve dhe sigurimi financiar, deri tek kryerja e pagesave të pretendimeve dhe standardet e praktikës në të gjithë botën. Guy Carpenter, synon të jetë një forcë pozitive për trajtimin e këtyre çështjeve dhe të tjerave, individualisht me klientët tanë dhe si agjent i ndryshimit në të gjithë biznesin”, - konkludoi Zaffino.

“Doktrina e Publikimit” të Guy Carpenter trajton format e shumëllojshme të kompensimit të firmës duke përfshirë përqindjet standarde të ndërmjetësit për vendosjen e traktateve, pagesën për shërbime dhe historinë e firmës me marrëveshjet e tregut, që kanë skaduar ose janë ndërprerë të gjitha. Si pjesë e “doktrinës së tij të publikimit” Guy Carpenter është angazhuar që të kryejë publikimet e mëposhtme në mënyrë të vazhdueshme:

- Kur një klient e emëron Guy Carpenter si ndërmjetës të dhënash, ne do t'i publikojmë klientit tonë kompensimin që parashikojmë të

marrim për shërbimet që do të kryejmë në emër të klientit.

- Përpara rinovimeve pasuese të kontratave të risigurimit, do të rishikojmë me klientin tonë kompensimin e pritur të Guy Carpenter, bazuar në përqindjet standarde të komisionit.
- Guy Carpenter do të vazhdojë të përpiqet për vazhdimësinë në përqindjet e ndërmjetësimit që do të fitojë Guy Carpenter brenda një shtrese dhe do të publikojë çdo ndryshim në përqindjet e të gjitha palëve brenda asaj shtrese.
- Ndërmjetësimi për çdo transaksion risigurimi do të listohet në shënimin e Mbulimit për të gjithë biznesin e traktatit.
- Politika e mësipërme mbulon vendosjen e traktatit globalisht, që përfaqëson më tepër se 90 % të të ardhurave të Guy Carpenter dhe do të zgjerohet për të përfshirë vendosjet fakultative kur të jetë përfunduar rishikimi mbarë botëror i praktikave aktuale.

### **Vendosja e Traktatit**

Në dritën e zhvillimeve të fundit që ndikojnë në këtë biznes, Guy Carpenter beson se është e rëndësishme të trajtohet çështja e kompensimit në tregun e ndërmjetësve të risigurimit dhe e klientëve tanë në këtë drejtim. Prandaj, Guy Carpenter zhvilloi këtë Doktrinë të Publikimit, e cila identifikon procedurat tona në lidhje me shërbimet që kryejmë, etikën që adoptojmë dhe mënyrën e përgjithshme në të cilën kompensohet Guy Carpenter.

### **Kompensimi dhe Shërbimet**

Më poshtë përshkruhet mënyra se si Guy Carpenter merr pagesën për shërbimet e vendosjes së traktatit të kryera si ndërmjetës risigurimi:

### **Komisionet e Ndërmjetësit**

Praktika afatgjatë e Guy Carpenter është konformimi me përqindjet e komisioneve të ndërmjetësit në përputhje me zakonet dhe

përdorimin e këtij biznesi. Ne gjithashtu vazhdojmë të mbështetim vazhdimësinë e përqindjeve brenda përqindjeve të pagesave të ndërmjetësisë për vendosjen dhe publikimin. Për këtë qëllim, Guy Carpenter parashtron më poshtë përqindjet e pagesave të ndërmjetësimit që do të aplikoheshin për shumicën e biznesit që ne vendosim. Këto përqindje janë udhëzuese dhe në përgjithësi janë standarde në treg por mund të variojnë sipas specifikave të vendosjes të veçantë:

- Guy Carpenter në përgjithësi merr pagesa ndërmjetësimi për vendosjet me përqindje midis 1% dhe 2.5% të primit bruto. Ka disa vendosje ku pagesa e ndërmjetësimit është më e madhe se 2.5%.
- Për tejkalimin e vendosjeve të humbjes, Guy Carpenter në përgjithësi merr pagesë ndërmjetësimi prej 10% të primit të kontratës.
- Kur tejkalimi i vendosjeve të humbjes bëhet në tregun e Londrës, kërkohet një pagesë ndërmjetësimi shtesë 5% dhe mbahet nga ndërmjetësi korrespondent i Londrës. Shpesh në këto vendosje përdoret një ndërmjetës i Londrës, pjesëtar i Guy Carpenter.
- Në disa tregje, Guy Carpenter merr pagesë ndërmjetësimi deri në 5% mbi primit e rehabilitimit.
- Në disa vendosje paguhet një marzh i deklaruar për risiguresin. Në këto raste, Guy Carpenter në përgjithësi merr 20% të marzhit.

### **Pagesa për Shërbim**

Përveç rolit tonë tradicional të ndërmjetësit të risigurimit, Guy Carpenter kryen gjithashtu kryhen shërbime të tjera “jo tradicionale” të lidhura me risigurimin për të cilat merr pagesa. E ardhura nga këto aktivitete përfaqëson një pjesë të vogël të të ardhurave vjetore të Guy Carpenter. Aktualisht, të dy shembujt parësorë të këtyre shërbimeve janë:

- Reinsurance Solutions International, LLC është një degë e Guy Carpenter që merr pagesa për



kryerjen e shërbimeve tërësore, të tilla si administrimi i politikës, administrimi i pretendimeve, mbledhja e primit/risigurimit, kontabiliteti i detyrueshëm/GAAP, përputhshmëria rregullatore dhe audititi. Veç këtyre, RSI kryen shërbime konsulente të specializuara duke u fokusuar në riinxhinierimin e procesit, vendosjen e standardeve, dhe matjen e menaxhimit të performancës dhe masat.

- Guy Carpenter & Company, inc., e Pensilvanisë është një degë e Guy Carpenter dhe është një menaxher i licencuar i risigurimit që mbikëqyr një fasilitet marrjeje në risigurim për risigurues të caktuar.
- Ky fasilitet marrjeje në risigurim merr përsipër biznesin e shoqërive më të vogla rajonale dhe reciproke.

### **Historia e Marrëveshjeve të Tregut**

Në të kaluarën, Guy Carpenter hyri në një numër të kufizuar marrëveshjesh me disa risigurues që i kryenin pagesa Guy Carpenter. Këto marrëveshje në total dhe në çdo vit përfaqësonin një përqindje shumë të vogël të të ardhurave totale të Guy Carpenter. Të gjitha këto marrëveshje ose kanë skaduar ose janë ndërprerë.

### **Publikimi**

Guy Carpenter beson se tregu i risigurimit do të përfitonte nga transparenca më e madhe me klientët në lidhje me kompensimin e ndërmjetësve. Për të promovuar këtë objektiv, Guy Carpenter do të zbatojë hapat e mëposhtme që hyjnë në fuqi më 1 janar 2005:

- Kur një klient emëron Guy Carpenter ndërmjetës të dhënave, ne do t'i publikojmë klientit tonë kompensimin që parashikojmë të marrim për shërbimet që do të jepen në emër të klientit.
- Para rinovimeve pasuese të kontratave të risigurimit, do të rishikojmë me klientin tonë kompensimin e pritur të Guy Carpenter, bazuar

në përqindjet standarde të komisionit.

- Guy Carpenter do të vazhdojë të përpiqet për vazhdimësinë e përqindjeve të ndërmjetësimit që do të fitohen nga Guy Carpenter brenda një shtrese dhe që do t'ua publikojë të gjitha palëve çdo ndryshim në përqindje brenda asaj shtrese.
- Ndërmjetësimi për çdo transaksion risigurimi do të listohet në Shënimin Mbulues për të gjithë biznesin e traktatit.

### **Aneksi IV - Fjalorth termash**

**Risigurim i pranuar** - një shoqëri është “e pranuar” kur është licencuar dhe pranuar nga autoritetet e duhura qeveritare të sigurimit të një shteti ose një vendi. Në përcaktimin e kushtit të tij financiar, një siguruesi cedues i lejohet të marrë kredi për primet e paftuara dhe pretendimet e papaguara për risqet e risiguruara, në qoftë se risigurimi vendoset në një shoqëri risigurimi të pranuar.

**Klauzola e Arbitrazhit** - term që garanton një mjet për zgjidhjen e dallimeve midis risiguruesit dhe të risiguruarit pa çështje gjyqësore. Zakonisht, secila palë emëron një arbitër. Të dy të emëruarit në këtë mënyrë zgjedhin një arbitër të tretë dhe vendimi me shumicë i të treve bëhet detyrues për palët në procesin e arbitrazhit.

**Bordero** – informacioni mbi primin ose të dhënat e humbjes në lidhje me risqet specifike të identifikuara që i jepen risiguruesit nga i risiguruari.

**Kostoja e pastër (Burning cost)** - një term që përdoret më shpesh në kontratat e risigurimit të pasurisë për të shprehur koston e pastër të humbjes ose, në mënyrë më specifike, përqindjen e humbjeve të ndodhura brenda një shume të specifikuar që e tejkalon mbajtjen e shoqërisë ceduese për primet e saj bruto mbi një numër të parashikuar vitesh.

**Anulimi** - a) Deri ne shuarje do të thotë detyrimi i risiguruesit sipas policave, të cilat kanë hyrë në

fuqi sipas traktatit para datës së anulimit të këtij traktati, do të vazhdojnë deri në skadimin e datës të çdo police; b) Me ndërprerje do të thotë detyrimi i risiguruesit sipas policave që kanë hyrë në fuqi sipas traktatit përpara datës së anulimit të këtij traktati, do të pushojnë në lidhje me humbjet që rezultojnë nga aksidentet që ndodhin në datën e anulimit dhe pas saj. Zakonisht risiguruesi do t'ia kthejë shoqërisë portofolin e primit të pa fituar përjashtuar rastin kur traktati është shkruar mbi bazën e primit të fituar.

**Kapaciteti** - përqindja e tepricës ose shumës së dollarëve të ekspozimit që siguruesi ose risiguruesi dëshiron t'i vendosë në risk. Kapaciteti mund të aplikohet për një risk të vetëm, një program, një linjë biznesi ose një libër të tërë biznesi.

**Risigurimi i Katastrofës** - një formë risigurimi që zhdëmton shoqërinë ceduese për akumulimin e humbjeve mbi shumën e parashikuar që lind nga një ngjarje katastrofike e tillë si zjarri, tërmeti apo stuhia. Humbja e katastrofës në përgjithësi i referohet humbjes totale të një shoqërie sigurimi që lind nga një ngjarje e vetme katastrofike.

**Cedoj** - kur një shoqëri risiguron detyrimin e saj me një tjetër, ajo “e cedon” biznesin.

**Komisioni i Cedimit** - kostot e marrjes së ceduesit dhe shpenzimet e përgjithshme, tatimet, licencat dhe pagesat, plus një pagesë që përfaqëson ndarjen e fitimeve të pritura, ndonjëherë të shprehur si përqindje e primit bruto të risigurimit.

**Shoqëria Ceduese** - siguruesi fillestar ose parësor, shoqëria e sigurimit që ble risigurimin.

**Mbi Bazën e Dëmeve të Ndodhura** - një formë risigurimi, sipas së cilës data e raportimit të dëmit konsiderohet se është data e ngjarjes së humbjes. Dëmet e raportuara gjatë periudhës së afatit të marrëveshjes së risigurimit mbulohen,

pavarësisht kur ato kanë ndodhur. Një marrëveshje mbi bazën e dëmeve të ndodhura thuhet se “redukon” biznesin e detyrimit, duke mos mbuluar dëmet e raportuara pas afatit të marrëveshjes së risigurimit, përjashtuar rastin kur shtyhet me marrëveshje të veçantë. Shih mbi Bazën e Ndodhjes.

**Komision** - në risigurim, shoqëria parësore e sigurimit zakonisht i paguan risiguruesit përqindjen e tij të primit bruto që merr mbi një risk. Risiguruesi pastaj i lejon shoqërisë një pagesë komisioni ceduese ose të drejtpërdrejtë mbi këtë prim bruto të marrë, aq sa të rimbursojë shoqërinë për komisionin që u ka paguar agjentëve të vet, plus taksat dhe shpenzimet e saj të përgjithshme. Shuma e kësaj pagese shpesh përcakton fitimin ose humbjen për risiguruesin.

**Klauzola e Komutacionit** - një klauzolë në një marrëveshje risigurimi, e cila parashikon preventivin, pagesën dhe shkarkimin e plotë nga të gjithë detyrimet e ardhshme për humbjet e risigurimit të ndodhura, pavarësisht natyrës vazhduese të disa humbjeve të tilla si përfitimet pa kufizim mjekësore dhe për gjithë jetën për kompensimin e punëtorëve.

**Komisionet Kontingjent** (ose komisioni i fitimit) - një pagesë që i bëhet shoqërisë ceduese përveç pagesës normale të komisionit cedues. Është një përqindje e paracaktuar e fitimeve neto të risiguruesit pas një pagese për shpenzimet e përgjithshme të risiguruesit, që rrjedhin nga traktati objekt.

**Teprica e Kontributit** - kur ka më tepër se një risigurues që ndan një linjë sigurimi mbi një risk më tepër se një mbajtje të specifikuar, çdo risigurues i tillë do të kontribuojë për çdo humbje të tepërt në proporcion me pjesëmarrjen e tij fillestare në këtë risk. Shembull: mbajtja 100.000 USD, risiguruesi A pranon një gjysmë pjese të ndarjes të kontributit prej një milionë USD më tepër të 100.000 USD të përmendura më

sipër. Risiguruesi B pranon gjysmën e mbetur të pjesës së ndarë të kontributit prej 1 milionë USD.

**Primi i Fituar** - (1) ajo pjesë e primit që aplikohet për pjesën e skaduar të periudhës së policës, duke përfshirë primin me përqindje të shkurtër për anulimin, primin tërësor mbi shumën e humbjes të paguar sipas disa kontratave dhe të gjithë primin mbi kontratën për skadimin e policës. (2) Ajo pjesë e primit të risigurimit të llogaritur mbi bazë mujore, tre mujore ose vjetore, e cila duhet të mbahet nga risiguruesi në qoftë se anulohet cedimi. (3) Kur një prim paguhet paraprakisht për një kohë të caktuar, thuhet se shoqëria “fiton” primin me avancimin e kohës. Për shembull, një policë e shkruar për tre vite dhe e paguar paraprakisht do të jetë “e fituar” 1/3 në fund të vitit të parë.

**Klauzola e Gabimeve dhe Komisioneve** - një dispozitë në marrëveshjet e risigurimit, e cila synon të neutralizojë çdo ndryshim në detyrimin apo përfitimet si rezultat i një gabimi pakujdesie nga secila palë.

**Teprica e Humbjes** - një formë e risigurimit sipas së cilës mund të bëhen rikuperimet kur një humbje e dhënë e tejkalon mbajtjen e ceduesit të përcaktuar në marrëveshje.

**Pagesa Ex Gratia** - një pagesë që bëhet për të cilën shoqëria nuk përgjigjet sipas termave të policës së saj. Zakonisht bëhet në vend të kryerjes të shpenzimeve ligjore më të mëdha për mbrojtjen e dëmishpërblimit. Rrallë haset në risigurim, meqenëse risiguruesi si zakon dhe për arsye praktike ndjek pasurinë e shoqërisë ceduese.

**Përqindja e Shpenzimit** - përqindja e primit që përdoret për të paguar të gjitha kostot e marrjes, shkrimit dhe kryerjes të shërbimit për sigurimin dhe risigurimin.

***Për këtë numër punuan:***

E. Shehi, R. Guri, F. Musta,  
R. Eltari, E. Basha, E. Kokona

